



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KODIFIKIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË LEGJISLACIONIT

Nr. 745 / prot.
2

Tiranë, më 12.02.2026

Lënda: Kthim përgjigje për kërkesën për informacion.

KUJTIM TOPUZI

Report TV, kujtimtopuzi@gmail.com, +355696729191

Në cilësinë e kërkuarit keni depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar kërkesën për dhënie informacioni, administruar pranë nesh me nr. 745 prot., datë 04.02.2026, si dhe regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve me numër rendor 14 datë 03.02.2026. Në vijim të kërkesës suaj ju informojmë si vijon:

Për pyetjen 1. A jeni konsultuar me Prokurorinë e Përgjithshme dhe SPAK për këto ndryshime? Nëse po, cili ka qenë vlerësimi i këtyre dy institucioneve për ndërhyrjet në këto dy nene?

Në kuadër të hartimit dhe konsultimit të projektligjit është kërkuar dhe është marrë edhe mendimi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK të cilët janë shprehur në kuadër të nismës, që si qëllim parësor ka përafrimin e legjislacionit me aktet e Bashkimit Evropian të cilat duhet të përafrohen në Kodin Penal.

Për pyetjen 2. Çfarë problematikash ka shfaqur zbatimi i paragrafit 7 të nenit 28, që të motivonte shfuqizimin e tij?

Neni 28 është i vendosur në Kreun IV të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal që rregullon institutin e bashkëpunimit të personave për kryerjen e veprës penale. Ky nen parashikon format e veçanta të bashkëpunimit duke dhënë përkufizimin përkatës për secilën prej tyre në kuadër të kuptimit që i jepet këtij instituti. Ndërsa çështjet që lidhen me individualizimin e dënimit, përfshirë rastet për përjashtimin ose uljen e dënimit përcaktohen në Kreun VI të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal mbi caktimin e dënimit, që përmban nenet 47 – 57. Në këto kushte, kjo çështje është rregulluar në nenin 52/a mbi përjashtimin ose uljen e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat.

Ndryshimi në nenin 28 është kryer duke u bazuar në nevojën për të përafruar siç duhet Direktivat e BE-së, në legjislacionin penal. Direktivat që janë përafruar janë shënuar në fund të faqes së parë të ligjit nr. 8/2026. Konkretisht, Direktiva (BE) 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 15 marsit 2017 për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kornizë të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e Vendimit të Këshillit 2005/671/JHA, si dhe Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA i 25 tetorit 2004, që përcakton dispozitat minimale mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës. Këto akte parashikojnë

uljen e dënimit për vepra të caktuara, duke e njohur këtë të drejtë për individin që plotëson kushtet përkatëse dhe që bashkëpunon me organet ligjzbatuese, ashtu siç kërkohet prej tyre. Pra, ulja e dënimit mund të jepet atëherë kur plotësohen kushtet të përcaktuara shprehimisht nga legjislacioni që lidhen me individualizimin e përgjegjësisë, heqjen dorë nga veprimtaria kriminale dhe me sigurimin e informacioneve të cilat, pa ndihmën e personit, autoritetet administrative ose gjyqësore nuk do të kishin qenë në gjendje t'i siguronin vetë.

Në këto kushte, bazuar në nevojën për përafrimin e dy akteve të sipërcituara, konkretisht nenit 16 të Direktivës (BE) 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe nenit 5 të Vendimit Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA, janë parashikuar shprehimisht kushtet për përfitimin e uljes së dënimit, ashtu siç është parashikuar në këto dispozita, duke bërë ndërhyrjen në nenin 52/a mbi përjashtimin ose uljen e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat, përmes shtimit të togfjalëshave “që heq dorë nga veprimtaria kriminale”, dhe “u siguron autoriteteve administrative ose gjyqësore, informacione të cilat ata përndryshe nuk do të kishin qenë në gjendje t'i siguronin.

Për pyetjen 3. A do të krijonte problem shfuqizimi i këtij paragrafi, në marrëdhëniet me bashkëpunëtorët e mundshëm të Drejtësisë?

Nenin 52/a, i Kodit Penal, me ndryshimet e kryera sipas arsyetimit më sipër përcakton qartë cilët janë subjektet që mund të përfitojnë përjashtim apo ulje dënimi si pjesëmarrës në veprimtari kriminal, përfshirë të gjitha format e parashikuara nga neni 28 i Kodit Penal që jep përkufizimin për secilën prej formave.

Për pyetjen 4. A e plotëson këtë mungesë Neni 52/a dhe shtesat që i janë bërë, pasi terminologjia dhe përkufizimi i personave që përfitojnë përjashtim apo ulje dënimi, është e ndryshme?

Siç është shpjeguar edhe më lart, aktet e BE-së të përafruara përmes ndryshimeve të kryera në Kodin Penal, në nenet e tyre përkatëse i referohen individit/subjektit konkret. Për të përfituar uljen e dënimit, ky individ duhet të plotësojë kumulativisht kushtet:

- Të ketë kryer veprën penale përkatëse;
- Të ketë hequr dorë nga veprimtaria kriminale; dhe,
- Të bashkëpunojë e ndihmojë organet e ndjekjes penale sipas përcaktimeve në Kodin Penal

Ndërkohë në raste të veçanta personi (përveç atij që ka kryer njëherë nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e lëndëve narkotike dhe psikotrope) mund të përjashtohet nga dënimi, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij.

Sa më sipër, rezulton se parimet e zbatimit të këtyre instituteve nuk kanë ndryshuar. Vetëm kur gjykata arrin në përfundimin se janë plotësuar kushtet e mësipërme, mund të vendosë se personi përfiton ulje dënimi (pra, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij) ose përjashtim nga dënimi. Në këtë kuptim, ulja e dënimit ose përjashtimi nga dënimi, nuk është një veprim thjesht matematikor apo automatik, por një vendim të cilin gjykata e merr duke vlerësuar në mënyrë tërësore e të gjithanshme rrethanat, provat dhe faktet që të çojnë në përfundimin se janë përmbushur kushtet e mësipërme. Ndërsa format e veçanta të bashkëpunimit të parashikuara nga neni 28, shërbejnë vetëm për të përcaktuar nivelin e rrezikshmërisë shoqërore të autorit dhe për të individualizuar dënimin që do t'i jepet atij.

Për pyetjen 5. Si argumentohet që përjashtimi nga dënimi, nuk përfitojnë ata që kanë kryer vepra penale që kanë lidhje me trafikimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope?

Nenet 4 dhe 5 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2004/757/JHA i 25 tetorit 2004, që përcakton dispozitat minimale mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës, i lënë diskrecion shteteve që të ndërmarrin ose jo masa efektive vetëm për uljen e dënimit dhe jo për përjashtimin nga dënimi. Prandaj, shtimi i togfjalëshit “përveç personit që ka kryer njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e lëndëve narkotike dhe psikotrope”, në fjalinë e dytë, të paragrafit të tretë të nenit 52/a, lidhet me përafrimin me dispozitat e sipërcituara duke parashikuar vetëm uljen e dënimit të autorëve e veprave penale që lidhen me trafikun e lëndëve narkotike dhe psikotrope dhe jo përjashtimin e tyre nga dënimi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

ZËVENDËSMINISTËR

Elona Hoxha

